



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Ramazan Rraja** me datë **22.10.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimi i humbjes së fuqisë së paraburgimit”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, bazuar në nenet 263, 1 pika “c”, 266 pika 1 të K.Pr.Penale, si dhe në vendimin Nr. 195, datë 24.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr. **597**, datë **24.10.2024**, vendosi:

1. Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit, konkretisht të masës së sigurimit “**Arrest në burg**”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale caktuar ndaj personit nën hetim **Ramazan Xhelal RRAJA**, me Vendimin Nr. 308, datë 21.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe zgjatuar me vendimin Nr. 439, datë 16.07.2024 të kësaj Gjykate, për shkak të kalimit të afateve të paraburgimit gjatë hetimeve paraprake.
2. Bazuar në nenin 266 pika 1 të K.Pr.Penale caktimin ndaj personit nën hetim **Ramazan Xhelal RRAJA**, të masës së sigurimit personal “**Arrest në shtëpi**” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.
3. Detyrohet personi nën hetim **Ramazan Xhelal RRAJA** të mos largohet nga banesa e tij me adresë: *****.
4. Detyrimin e personit nën hetim **Ramazan Xhelal RRAJA**, të mos komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të.
5. Zbatimi dhe mbikëqyrja e kësaj mase të bëhet nga oficerët e policisë gjyqësore që mbulojnë vendbanimin e personit nën hetim **Ramazan Xhelal RRAJA**.
6. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 24.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar